

FATMIRA MUSAJ

RIORGANIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA NË SHQIPËRI (1925-1928)

Organizimi i ushtrisë

Pas rikthimit në pushtet A. Zogu dhe qeveria e tij, i kushtuan vëmendje riorganizimit të forcave të armatosura. Riorganizimi i tyre ishte i një rëndësie të veçantë sepse kishte të bënte me sigurimin e rendit, qetësisë dhe mbrojtjen e vendit.

Ngjarjet e vitit 1923 dhe veçanërisht implikimi i ushtrisë, komandës së lartë dhe oficerëve në kryengritjen e qershorit të vitit 1924 duke u bërë palë me opozitën, dëshmuar për politizimin e saj dhe largimin nga detyra kryesore që i kishte caktuar ligji. Në gjendjen ekzistuese, ajo nuk mund të konsiderohej një sektor i sigurt për stabilizimin e brendshëm dhe mbrojtjen e vendit. Kështu A. Zogu ende pa marrë votëbesimin e qeverisë në Kuvendin Kushtetues, mori një sërë masash për largimin e ushtarakëve nga jeta politike dhe neutralizimin e rrezikshmërisë së ushtrisë. Fillimisht u suprimua Ministria e Luftës që përmbante funksionin politik dhe u lanë pa detyra komandat e reparteve e nënreparteve që do të riorganizoheshin. U nxorën në lirim dhe u larguan nga detyra një numër i konsiderueshëm oficerësh, të cilët u konsideruan të “tepërt” dhe një pjesë prej tyre për arsye moshe, dolën në pension. Në mbledhjen e Asamblesë së janarit 1925, A. Zogu këtë veprim ndaj ushtrisë, veç shkaqeve politike, e argumentoi edhe me mundësitë e pakta financiare të shtetit, të cilat nuk mund të mbanin një ushtri prej afro 7000 vetësh dhe se kishte ndërmend të krijonte një ushtri të vogël dhe efektive prej 1200 vetësh.¹ “Si rezultat i këtyre masave, njoftonte konsulli italian në Sarandë, regjimenti i parë në Përmet ishte shkrirë, pjesa më e madhe e ushtarakëve ishin liruar”.² Përfshirja e ushtarakëve të lartë, në shoqëri,

¹ Bisedimet e Kuvendit Kushtetues. Mbledhja nr. 65, 21.01.1925, Votëbesimi i qeverisë, f. 889-891.

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 163, viti (më tej V.) 1925, dosja (më tej: D.) 2, fl.7. Telegram i agjencisë konsullore italiane Sarandë, Legatës Mbretërore italiane në Durrës, 20.2.1925.

organizata, grupime e më pas në partitë politike, shtyu qeverinë që në janar 1925 të nxirrte vendimin për mbylljen e të gjitha shoqërive politike e kulturore.³ Gjithashtu, ligji zgjedhor i këtij viti ashtu si dhe ai i vitit 1923, në nenin 8 të tij, përjashtonte ushtrinë, xhandarmërinë, oficerët dhe nënoficerët nga e drejta e votës. Por, ligji i vitit 1925 merrte edhe një masë më të fortë në këtë drejtim, krahasuar me atë të vitit 1923. Neni 11 i tij sanksiononte se, ushtarakët të cilët kandidonin për deputetë nëse nuk fitonin ose kur mbaronin mandatin, nuk kishin të drejtë të ktheheshin në ushtri, me përjashtim të atyre rasteve kur qeveria e shihte të nevojshme⁴.

Ndërkohë u morën masa për ngritjen e strukturave të larta të Forcave të Armatosura që do të zëvendësonin Ministrinë e Mbrojtjes. U krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqisë Armate (KPFA), në krye të së cilës u emërua Xhemal Araniti. Ky veprim ishte hapi i parë për të ngritur një strukturë të re të forcave të armatosura që do të kryente detyra të përcaktuara me ligj, të kontrolluara e të komanduara prej A. Zogut. KPFA përbëhej nga 27 oficerë e aspirantë, 3 civilë me rrogë, 7 nënoficerë me rrogë, dy shoferë dhe një ushtarak të huaj si këshilltar.⁵ Me efektivat ekzistuese, u bënë përpjekje për t'i riorganizuar në nënreparte të reja. U krijuan tre kompani stërvitje me një efektiv me më pak se 100 vetë secila, me bazë në Delvinë, Përmet e Korçë.⁶ Gjithashtu u ruajt përkohësisht struktura e tre komandave të grupeve me qendër në Tiranë, Shkodër e Berat. Organika e tyre ishte e kufizuar. Ato përbëheshin nga një intendent (aspirant), një mjek me gradën kapiten i II, një veteriner toger, një

³ Proletar Hasani, Engjëllushe Sula, Asllan Zemani, *Histori e ushtrisë shqiptare*, Tiranë: 2004, fl.168.

⁴ *AQSh*, F. 149, V. 1925, D. I-753, fl. 14-31; *Ligji i zgjedhjeve në Shqipëri*, Tiranë: "Mbrothësia", 1925, f. 17.

⁵ Teki Selenica, *Shqipëria në 1927*, Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", 1928, fl. XXIII. Struktura e ushtrisë në vitin 1924 përbëhej nga: 280 aspirantë, 245 oficerë, 160 nënoficerë dhe 5318 ushtarë. Këto forca ishin të organizuara në tre grupe me nga tre batalione, tre kompani këmbësorie, një kompani mitraljerë, pesë kompani kufitare, një kompani e qendrës në Tiranë, një kompani xheniere, 9 drejtori rekrutimi, një spital në Tiranë, banda ushtarake dhe një depo qendrore. Koloneli Gustav Myrdac, kishte ardhur nga Austria në Shqipëri qysh në vitin 1923, me kërkesë të qeverisë shqiptare, për të ndihmuar në organizimin e ushtrisë shqiptare.

⁶ *AQSH*, F.163. V. 1925, D. 2, fl.7. Telegram i konsullatës italiane në Sarandë, Legatës Mbretërore italiane në Durrës, 20.2.1925.

armëtar aspirant, gjashtë nënoficerë dhe një ushtar ordinancë.⁷ Në fund të vitit 1925, organika e komandave u zgjerua me nga 20 oficerë aktivë. Për kompletimin e tyre me kuadro u zbatua me rreptësi kriteri politik, e më pas ai ligjor, duke vendosur në detyra vetëm ata oficerë që nuk ishin përfshirë në kryengritjen e qershorit 1924. Ndërsa për kompletimin me ushtarë, KPFA mori masa për të kthyer të gjithë ushtarët që ishin larguar nga repartet e tyre të paraqiteshin në qendrat e grupeve për të përfunduar shërbimin ushtarak ose të pajiseshin me fletë shërbimi të gjithë ata që e kishin përfunduar atë.⁸

Duke vlerësuar se ushtria në gjendjen ekzistuese nuk mund t'i bënte ballë e vetme një situatë të jashtëzakonshme që mund të shkaktohej nga forca të jashtme ashtu dhe nga kundërshtarë brenda vendit, u pa e arsyeshme që Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë (KPXH), të bashkohej administrativisht me KPFA. Në shkurt 1925 u krijua Komanda e Mbrojtjes Kombëtare ose Shtatmadhuria.⁹ Në krye të saj u caktua koloneli austriak Gustav von Myrdac (Mirdash). Kjo komandë do të merrej me çështjet e ushtrisë e të xhandarmërisë, si rekrutimin, mobilizimin, stërvitjen ushtarake, problemet e armatimit, municioneve, teknikën, çështjet personale të oficerëve e xhandarëve dhe me administrimin.¹⁰

Reforma në ushtri, pengesat për realizimin e saj

A.Zogu, kreu i Shtatmadhorisë dhe KPFA, pranuan rekomandimin e këshilltarëve të huaj për riorganizimin e ushtrisë mbi bazën e sistemit të milicisë.¹¹ Ideja e zbatimit të këtij sistemi për ngritjen dhe funksionimin e ushtrisë shqiptare, ishte hedhur qysh në vitin 1913 nga qeveria e Përkohshme e Vlorës, por ajo u konkretizua në qeverisjen e princ Wied-it

⁷ *Po aty*, F.149, V.1925, D.II-137, fl.134. Shih Azis Bulica, *Logjistika-Shkencë. Historiku i saj në ushtrinë shqiptare*, Qendra e Shtypit, Botimeve dhe përkthimeve ushtarake, Tiranë: 2009, f. 107.

⁸ *Fletorja Zyrtare*, 26.I.1925, f.1. Mbi ushtarët e shpërndarë. Shkresë e KPFA-së drejtuar pleqësive të katundeve, Tiranë, 8.01.1925.

⁹ *AQSH*, F.149, V.1925, D.II-148. Telegram i Komandantit të Përgjithshëm të Fuqisë Armatë, Kryesisë së Republikës, Tiranë, 3.2.1925.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*, F.178, V.1925, D. I-745, fl.1. Vendime të Kryesisë së Republikës dhe Shtatmadhorisë mbi projektin për organizimin e ushtrisë dhe xhandarmërisë. Kryesia e Republikës, Ministrisë së Financave, Tiranë 21.12.1925.

në vitin 1914 e u përfshi në një nga pikat e Statutit të Principatës Shqiptare. Koha e shkurtër e qeverisjes së Princit, nuk mundësoi zbatimin e këtij sistemi në organizimin e ushtrisë. Sistemi i milicisë iu sugjerua qeverisë shqiptare edhe në vitin 1922 nga ekspertë të Lidhjes së Kombeve dhe në veçanti nga organizatori i financës Hunger.* Në raportin e tij dërguar Lidhjes së Kombeve, ai nënvizonte se, ngritja dhe mbajtja e një ushtrie aktive në Shqipëri, kërkonte shpenzime të konsiderueshme të cilat vinin në rrezik financat e shtetit.¹² Mirëpo gjatë viteve 1920-1924 qeverisja e vendit nuk i zbatoi këshillat e tij. Nisur nga situata e brishtë politike brenda vendit si dhe ndërhyrjet e shteteve fqinje për të penguar konsolidimin e shtetit shqiptar, u ngrit një ushtri prej afro 7000 vetësh, e cila rëndonte në buxhetin e shtetit. Faktikisht rreziku i ndërhyrjeve nga shtetet fqinjë nuk u mënjanua pas rikthimit të A. Zogut në pushtet, ai ka qenë kurdoherë i pranishëm. Veçanërisht kur shteti shqiptar u përball me rivalitetin për influencë të dy shteteve fqinjë, Italisë dhe Jugosllavisë, të cilat ndikuan drejtpërdrejt në tërë veprimtarinë e brendshme dhe të jashtme të tij, përfshirë edhe angazhimin e qeverisë për ringritjen e forcave të armatosura. A.Zogu ishte i ndërgjegjshëm se me financat e varfra që kishte trashëguar por edhe për vështirësitë që pengonin përmirësimin e shpejtë të tyre, ishte e nevojshme krijimi i një force të armatosur për t'iu përgjigjur agresionit të jashtëm deri në atë masë sa të krijonin precedentin dhe të sensibilizonin opinionin dhe institucionet ndërkombëtare si dhe të ruante rendin e qetësinë nga elementë që mund të aktivizoheshin brenda vendit.

Për realizimin e një force të tillë, u hoq dorë nga sistemi ekzistues i kazermës. Thelbi i sistemit të zgjedhur qëndronte në krijimin e një Komande të Lartë, e cila drejtonte një trupë të qëndrueshme të përbërë prej oficerësh e nënoficerësh të cilët ishin në funksionin e instruktorëve të llojeve të ndryshme të armëve e shërbimeve ushtarake. Ata do të stërvitnin rekrutët për një kohë të caktuar, të cilët më pas do të kalonin në rezervë. Rezervistët do të mobilizoheshin në situatë gatishmërie dhe do të inkuadroheshin në nënreparte e reparte ushtarake. Stërvitja e rekrutëve do të përbënte detyrën kryesore e të qëndrueshme të trupës së oficerëve e

* Komiteti financiar i Lidhjes së Kombeve në prill të vitit 1923 caktoi J. Hunger si këshilltar financiar pranë qeverisë shqiptare.

¹² *Po aty*. Në vitin 1921 ushtria përbëhej prej 7000 vetësh dhe për atë shpenzoheshin 5 deri 7 milion fr ar.

nënoficerëve aktivë. Ata do të përjashtoheshin nga shërbime të tjera përfshirë dhe ato të krijuara në situata të jashtëzakonshme. Me këtë organizim, ushtria do të kryente vetëm detyrën e mbrojtjes së atdheut dhe u vendos që ajo të lirohej nga dy shërbime, ai i ruajtjes së rendit e qetësisë së vendit dhe atë të kufijve shtetërorë.¹³ Këto dy shërbime u ngarkuan si detyrë xhandarmërisë.¹⁴ Trupa rezerviste nga mosha 20 deri në 42 vjeç, tashmë e stërvitur, do të përfshihej në organizimin ushtarak në reparte e nënreparte. Mosha 20 deri 32 vjeç do të konsiderohej rezervë e parë dhe ajo 32 deri 42 vjeç, rezervë e dytë. Numri i trupës rezerviste do të vinte në rritje nga viti në vit, në varësi të shtimit të buxhetit, për të përballuar shpenzimet e tyre. Buxheti i vitit 1925-1926 për ushtrinë ishte vetëm 1339 milion fr.ari. Ky buxhet mund të përballonte stërvitjen dhe mbajtjen e 1500 rekrutëve për gjashtëmujorin e parë dhe të një kontingjenti prej 3000 rekrutëve për gjithë vitin.¹⁵ Këtë vit numri i meshkujve në moshën e përshtatshme për mobilizim ishte rreth 4500-5000 vetë. Prej këtyre, 2000 vetë që nuk i përballonte buxheti, liroheshin nga shërbimi ushtarak. Ata përzgjidheshin nga familjet me gjendje të dobët ekonomike dhe cilësoheshin si “pandihmës”. Për të vendosur një farë barazie midis atyre që thirreshin për t’u stërvitur dhe të “pandihmëve”, u parashikua që këta të fundit të paguanin një taksë ushtarake, e cila u përcaktua në ligjin mbi rekrutimin.¹⁶

Gjithashtu aty përcaktohej koha e stërvitjes së rekrutëve. Periudha gjashtëmujore e stërvitjes së rekrutëve të këmbësorisë ishte e ndarë në tre periudha. Në tremujorin e parë do të kryhej stërvitja vetmore, në atë dymujore stërvitja në grup, skuadër-togë, dhe në muajin e fundit, kryhej stërvitja e kompaktësimit të kompanisë. Ndërsa stërvitja për armën e artillerisë zgjaste një vit pasi ishte më e vështirë për t’u përvetësuar. Realizimi i planit të mësipërm kërkonte oficerë të përgatitur dhe të aftë fizikisht. Prandaj ishte e nevojshme vënia në funksionim e shkollës ushtarake ku do të çelej edhe një degë për përgatitjen e oficerëve rezervistë. Në zbatim të këtij plani, ushtria do të kishte këtë strukturë: KPFA-në, e cila do të kishte në vartësi të saj nëntë kompani instruksioni këmbësorie, tre kompani instruksioni mitralierë, dy bateri instruksioni

¹³ *Po aty*, fl. 2.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*, fl. 15.

¹⁶ *Po aty*, fl. 6. Ligje, dekretligje e rregullore të vitit 1926, Tiranë 1938, fl.23; “Ligj mbi rekrutimin 20.01.1926”, në: *Fletorja Zyrtare*, nr. 32, 09.02.1926.

artilerie si dhe një instruktor të përgjithshëm për stërvitjen e administrimit. Për nevojat e logjistikës, do të kishte një kompani për përpunimin e veshmbathjes, një togë për nevojat e ordinancës me qendër në Tiranë, një kryemagazinë të përgjithshme në Tiranë dhe depo në rrethe. Gjithashtu do të ngrihej gjykata ushtarake dhe banda e ushtrisë.¹⁷

Organizimi i strukturave të mbrojtjes në formën e përshtatshme dhe sigurimi i mobilizimit të kontingjenteve në rast nevoje, do të bëhej në përputhje me evidencën e kontingjentit të rezervistëve në zona të ndryshme të rekrutimit në vend. Ky organizim do të bëhej në mënyrë graduale dhe sipas mundësive financiare. Fillimisht do të ngrihej nga një batalion në çdo zonë rekrutimi, gjithsej nëntë batalione. Çdo batalion do të përbëhej nga tre kompani këmbësorie dhe një kompani mitralierë. Në të ardhmen do të krijoheshin edhe nga një batalion i dytë, pra gjithsej tetëmbëdhjetë batalione. Me tre deri në tetë batalione, ishte parashikuar të krijoheshin një grupim, i cili do të kishte në përbërje edhe artileri, kolona të kafshëve të ngarkesës. Në efektivin e batalionit do të kishte 19 oficerë e aspirantë, 600 nënoficerë e ushtarë dhe 70 kafshë. Efektivi i ushtrisë do të përbëhej prej 360 oficerë e aspirantë, 12 mijë nënoficerë e ushtarë dhe rreth 1300 kafshë. Me këtë organizim do të përmbyllet faza e parë e organizimit të ushtrisë mbi bazën e sistemit të milicisë.¹⁸

Organizimi i ri, i cili do të hynte në fuqi me 15.2.1925¹⁹, do të kushtëzohej nga një sërë faktorësh si: sigurimi i kuadrit efektiv, gjendja financiare e lidhur ngushtë me mundësinë e sigurimit të ndihmës nga shtete të tjera e sidomos nga Italia, stabiliteti politik dhe garantimi i rendit e qetësisë në vend. Nevoja për oficerë e nënoficerë ishte e ndjeshme. Largimi i një pjese të oficerëve e nënoficerëve opozitarë jashtë vendit, si dhe të tjerë të larguar për shkaqe politike dhe të reformës, kishte krijuar mangësi jo të vogla në kuadrin komandues të ushtrisë. Për të zbutur sa të ishte e mundur këtë mungesë, u mendua që nga ky kontingjent (brenda vendit) të rimerreshin në shërbim oficerët më të përgatitur e më pak të

¹⁷ *Po aty*, F.178, V. 1925, D. I-745, Vendime të Kryesisë së Republikës, Shtatmadhorisë etj., mbi projektin e këshilltarëve të huaj, mbi organizimin e ushtrisë dhe të xhandarmërisë. Kryesia e Republikës, Ministrisë së Financave, Tiranë, 21.12.1925, fl.7.

¹⁸ *Po aty*, fl.8.

¹⁹ *Po aty*, F.152, V. 1925, D. 334, fl.7. Telegram i KPFA-së, MPB, Tiranë, 15.2.1925.

implikuar në politikë. Kryesisht më të preferuar ishin oficerët e rinj, të cilët do të kryenin detyra në funksione të ulta.²⁰

Riorganizimi i ushtrisë kishte nevojë për kuadro të pajisur me kulturë ushtarake, prandaj në plan ishte parashikuar çelja e shkollave ushtarake për përgatitjen e oficerëve me dije bashkëkohore të artit ushtarak dhe sidomos për zotërimin e armëve të artilerisë, xhenios, teknikës, armatimit, etj.

Rekrutimi

A. Zogu dhe instancat drejtuese të ushtrisë i kushtuan vëmendje të veçantë rekrutimit duke e vlerësuar atë si hallkën bazë për vendosjen e shërbimit ushtarak mbi baza ligjore dhe miradministrimin e burimeve njerëzore.

KPFA-ja në shkurt të vitit 1925, paraqiti projektplanin për përmirësimin e shërbimit të rekrutimit ushtarak ku përcaktohej ngritja e nëntë drejtorive të rekrutimit. Ato do të kishin një numur të barabartë personeli dhe do të ushtronin veprimtarinë e tyre në zona me popullsi pothuajse të barabartë.²¹ Shtrirja territoriale e tyre do të ishte sipas tabelës:

Zona	Rajonet që përfshinte çdo zonë	Numri i popullsisë	Totali
Korça	Korça	58869	
	Bilishti	19057	
	Kolonja	10522	
	Leskoviku	7490	
			95938
Berati	Berati	32204	
	Gramshi	15741	
	Skrapari	14709	
	Fieri	15381	
			85235
Tepelena	Tepelena	18.589	
	Përmeti	22468	

²⁰ *Po aty*, F.178, V. 1925, D. I-745, fl.13. Vendime të Kryesisë së Republikës, Shtatmadhorisë etj., mbi organizimin e ushtrisë e të xhandarmërisë. Kryesia e Republikës, Ministrisë së Financave, Tiranë 21.12.1925.

²¹ *Po aty*, F.149, V. 1925, D. 475, fl.1. Projekt i degës së rekrutimit të KPFA-së, Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Tiranë, 2.3.1925.

	Vlora	35930	
	Mallakastra	7890	
			94877
Delvina	Delvina	28140	
	Gjirokastra	25123	
	Libohova	18359	
	Himara	7815	
	Kurveleshi	10584	
			90601
Elbasan	Elbasani	65389	
	Pogradeci	12351	
			88899
Kavaja	Kavaja	17897	
	Lushnja	27895	
	Kruja	15376	
			86267
Mati	Mati	39925	
	Zerqani	24505	
	Tirana	34333	
			98773
Shkodra	Shkodra	36697	
	Lezha	14041	
	Mirdita	16384	
	Malësia e Madhe	19661	
	Dukagjini	9154	
			95337
Luma	Luma	20870	
	Kruma	15445	
	Bunjaj	13620	
	Peshkopia	28769	
	Puka	12592	
			91305

Shërbimi ushtarak ashtu si më parë, ishte i detyrueshëm. Drejtoritë e rekrutimit sipas zonave, do të siguronin mobilizimin e të gjithë kontigjenteve të afta të përcaktuara me ligj në rast gatishmërie.²² Veç drejtorive të mësipërme do të krijohesh një drejtori e përgjithshme.

²² *Po aty*, F.149, V.1925, D.II-142, fl.1. Akt propozimi për mënyrën e stabilizimit të degës së rekrutimit të KPFA-së, Kryesisë së Republikës, Tiranë, 2.3.1925.

Gjithashtu në KPFA do të krijohet një degë rekrutimi e drejtuar nga një major e një nëntoger.

Avancimi në grada i oficerëve të kësaj dege, do të bëhet jo vetëm në respektim të plotësimi të afatit kohor të përcaktuar në rregulloren përkatëse, por edhe në varësi të lirimit të vendit në organikën e grupit përkatës. Për rëndësinë që kishte kjo degë për ushtrinë, oficerëve të rekrutimit për të mos u krijuar pengesa në trajtimin financiar, i cili bëhet në bazë të gradës, do t'u shtohet rroga në çdo dy vjet, bazuar në aftësitë personale²³.

Gjithashtu, KPFA, për të ruajtur stabilitet në personelin e shërbimit të rekrutimit dhe për të siguruar mbarëvajtjen e punëve të degës, i propozoi Kryetarit të Republikës që të kufizohej sa të ishte e mundur, transferimi i oficerëve nga një zonë në tjetrën. Propozimi u miratua prej tij.²⁴

Më 1 mars 1925, kontingjenti i parë i rekrutëve filloi stërvitjen ushtarake i organizuar në strukturat sipas planit të miratuar, e cila do të vazhdonte deri më 31 gusht të atij viti. KPFA ndiqte me kujdes mbarëvajtjen e stërvitjes në nëntë qendrat stërvitore të rekrutëve dhe mori masat e nevojshme për të zgjidhur problemet e tyre si, kompletimin me kuadrin e nevojshëm, përmirësimin e kushteve të jetesës, veshmbathjen, ushqimin, etj. Vëmendje të veçantë KPFA i kushtoi disiplinimit të procesit të rekrutimit duke bërë përmirësimet e nevojshme në rregulloren ekzistuese të rekrutimit. Në rregullore u shpreh qartë kërkesa për të bërë kontrollin fizik të rekrutëve, u përcaktuan kriteret për ata rekrutë që do të përjashtoheshin nga shërbimi ushtarak, duke u prerë rrugën justifikimeve dhe ndërhyrjeve të pushtetarëve të niveleve të ndryshme, që ndikonin negativisht në këtë proces.²⁵ U parashikuan masa të rrepta ndëshkimi ndaj atyre që i shmangeshin shërbimit ushtarak dhe u përcaktuan detyrat për organet e pushtetit lokal të cilët do të merreshin me mobilizimin e rekrutëve në zonat përkatëse.²⁶ Zbatimi i kërkesave të rregullores bëri të mundur që në vitin 1926 në nëntë zonat e rekrutimit të kryhej rekrutimi i kontingjentit, që kishin lindur më 1906.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, fl.6. Telegram i Kryetarit të Republikës, KPFA-së, Tiranë, 6.7.1925.

²⁵ *Fletorja Zyrtare*, nr.190, 26 tetor 1926, f.1.

²⁶ *Po aty*.

Mbështetur në përvojën e fituar gjatë vitit 1925 dhe për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të organizimit të ushtrisë, në janar të vitit 1926, u paraqit për diskutim në parlament ligji përfundimtar mbi rekrutimin, i cili u miratua dhe hyri në fuqi në shkurt 1926²⁷. Ligji detyronte çdo mashkull, shtetas shqiptar, që kishte mbushur moshën 20 vjeç, për të bërë shërbimin ushtarak²⁸. Rekrutët pasi kryenin një vit shërbim të detyrueshëm ushtarak, kalonin në rezervë dhe i detyroheshin mobilizimit në situatë të jashtëzakonshme. Ky detyrim shtrihej nga moshë 20 deri 44 vjeç, i ndarë në 2 grupmosha: 20 deri 32 vjeç dhe 32 deri 44 vjeç. Ndërsa oficerët dhe nënoficerët aktivë që kishin shërbyer në ushtri me pagesë dhe për arsye të ndryshme ishin larguar nga ushtria, do të shërbenin si rezervistë deri në moshën 60 vjeç. Në muajin shkurt, në zbatim të ligjit, hyri në fuqi rregullorja e rekrutimit.²⁹ Në rregullore përcaktoheshin detyrat e drejtorive të rekrutimit për nxjerrjen e listave të rekrutëve, marrja nën armë, transporti dhe lirimi i tyre nga shërbimi ushtarak. Me masat e marra për zbatimin e ligjit dhe rregullores, u arrit që në vitin 1927 të kryenin shërbimin ushtarak 7000 vetë nga 5318 në vitin 1924.³⁰

A. Zogu, nisur jo vetëm nga rëndësia që kishte ushtria për mbrojtjen e vendit por dhe për shkak të formimit me kulturë dhe arsim ushtarak, ndiqte nga afër veprimtarinë që kryhej në ushtri dhe kërkonte që të gjitha hallkat e saj të vepronin duke u bazuar në ligj. Në këtë mënyrë ai synonte të shmangte sa të ishte e mundur sjelljet abuzive e arrogante të oficerëve dhe veçanërisht keqtrajtimin që ata u bënin ushtarëve në stërvitje e në shërbime të tjera. “Ushitari që thyen disiplinën, theksonte A. Zogu, duhet të dënohet vetëm në bazë të ligjeve të ushtrisë”³¹. Po kështu ai vlerësonte dhe figurën morale të oficerit. Në udhëzimet dërguar strukturave të larta të ushtrisë ai kërkonte të mbahej qëndrim i ashpër ndaj sjelljeve të pahijshme të oficerëve në ambiente publike, mbajtjen keq prej tyre të uniformës ushtarake, marrjen e dhuratave dhe borxhe nga ushtarët, mashtrimin dhe shoqërimin e oficerëve me persona me vese etj. Për të

²⁷ *Ligje Dekret Ligje e Rregullore, viti 1926*, Botime të Këshillit të Shtetit, Tiranë: Shtypshkroja “Tirana”, 1938, f.17; *Fletorja Zyrtare*, nr.32, 09.02.1926.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Fletorja Zyrtare*, nr.36, 13.2.1926.

³⁰ T. Selenica, *Shqipëria...*, f. LXXIX.

³¹ *AQSH*, F.149, V.1925, D. II-145, f.1. Urdhër i Presidentit të Republikës, KPFA-së, Tiranë, 16.5.1925; *Gazeta e Korçës*, nr. 188, 26.05.1925, f.2.

ruajtur të pastër figurën e oficerit, A.Zogu miratoi në fund të vitit 1925 ndryshime në kodin penal ushtarak ku sanksionoheshin masa disiplinore si degradime, përjashtime nga ushtria deri në ndëshkime me burg, përfshirë edhe oficerët madhorë nëse kryenin veprime të tilla.³²

KPFA dhe A. Zogu synuan që në ngritjen e funksionimin e ushtrisë të tërhiqnin oficerë të huaj të cilët me përvojën dhe dijet e tyre, do të ndihmonin në modernizimin e ushtrisë shqiptare e do të kontribuonin kryesisht në stërvitjen e llojeve të ndryshme të armëve dhe në përgatitjen e kuadrove. Por, ata fillimisht u treguan të kujdesshëm në tërheqjen e tyre, duke mbajtur larg oficerë të vendeve fqinje, sidomos ata nga Greqia dhe Jugosllavia, për të mos i përzier në mbrojtjen e vendit. Kështu nga kërkesat e oficerëve të huaj për t'u punësuar pranë ushtrisë shqiptare në vitin 1925, u preferua një oficer nga Austria si njohës i mirë i armatimit dhe municioneve, i cili do të shërbente në seleksionimin e materialeve që dispononte ushtria në atë kohë dhe të vendoste administrimin e rregullt të armatimit dhe municionit që do të mbetej për përdorim në ushtri. Po kështu u mor me kontratë njëvjeçare një oficer italian, i cili do t'u mësonte oficerëve shqiptarë përdorimin e armëve të artillerisë.³³ Në plotësim të strukturës së KPFA-së, në maj të vitit 1925, nënkolonel Leon Gjilardi, u emërua inspektor i përgjithshëm i ushtrisë.³⁴ Kompetencat dhe detyrat e tij u përcaktuan në rregulloren për inspektorinë e përgjithshme që u miratua në dhjetor 1925.³⁵ Ai do të kryente inspektimin dy herë në vit si për çështjet ushtarake ashtu dhe ato administrative në ushtri.

Në ecurinë e riorganizimit dhe reformimit të ushtrisë, ndikoi situata e brendshme dhe e jashtme e Shqipërisë. Viti 1925 u shoqërua me pasiguri në vend, e cila stimulohej dhe nga prania e elementëve kundërshtarë të regjimit si dhe nga vështirësitë ekonomike që ekzistonin në shoqërinë shqiptare. Politika fiskale e shtetit për të mbledhur taksat e prapambetura, rriti pakënaqësinë në popull dhe sidomos në zonat e varfra në veri dhe në lindje të vendit. Situata u rëndua shumë edhe nga sjelljet

³² *Po aty*, F.149, V. 1926, D.II-188, fl.12-13. KPFA, Kryesisë së Republikës, Tiranë 13.1.1926. Modifikimi i nenit 200 të kodit penal ushtarak; *Fletorja Zyrtare*, nr.99, 26.05.1926.

³³ *Po aty*, F.149, V.1925, D.II-182, fl.1. KPFA, Kryesisë së Republikës, Tiranë 4.6.1925.

³⁴ *Po aty*, F.149, V. 1925, D. II-181, fl. 27. Dekret emërimi i Kryetarit të Republikës, KPFA-së, Tiranë 29.5.1925.

³⁵ *Po aty*, F.152, V. 1925, D.334, fl. 41-44. Rregullore, Tiranë 03.12.1925.

korruptive e abuzive të zyrtarëve të lartë, veçanërisht hetimi parlamentar i M.Libohovës për korrupsion, si dhe ato të kompanive shëtitëse. Të krijuara me forca që nuk kishin njohuri ushtarake dhe të shpërndara në të gjithë vendin për të vendosur rendin dhe qetësinë, me veprimet e tyre destabilizuese u kthyen në elementë problematik për qeverinë.³⁶ Megjithëse i ndodhur para kësaj situatë kritike, A. Zogu për momentin e shihte të domosdoshëm ekzistencën e 10 kompanive shëtitëse deri në ngritjen e strukturave të ushtrisë. Kështu atij nuk i mbeti alternativë tjetër veçse të kërkonte forcimin e disiplinës në radhët e tyre. Mbështetur në informacionet që i vinin nga i gjithë vendi, si komandant i operacionit dhe më pas si Kryetar i Republikës, me anë të urdhëresave dhe qarkoreve drejtuar komandave, kërkonte marrjen e masave të rrepta deri në ndjekje penale, kundër fuqive civile që me sjelljet e tyre cenonin besimin e popullit tek regjimi. Kjo gjendje e vështirë mund të shfrytëzohej jo vetëm nga kundërshtarë të brendshëm të tij por ajo ndiqej me vëmendje nga shtetet fqinje veçanërisht Italia dhe Jugosllavia, të cilat përpiqeshin me të gjitha format për ta tërhequr A. Zogun nën influencën e tyre, duke shfrytëzuar edhe emigracionin politik shqiptar. Ministria e Brendshme ndiqte nga afër situatën në vend dhe informonte Kryetarin e Shtetit dhe KPFA se gjendja në Veri dhe veçanërisht në qarkun e Shkodrës nuk ishte e mirë dhe se ajo mund të shfrytëzohej nga qarqet jugosllave.

Për të përballuar ndonjë lëvizje të mundshme, ministri i Brendshëm Ceno bej Kryeziu, në maj 1925 i propozoi Kryetarit të Republikës dhe KPFA-së marrjen e masave të nevojshme në radhët e ushtrisë. Ai kërkoi që të largoheshin nga nënrepartet ushtarake nëntogeri Lazër Marashi, toger Spiro Moisiu, Nexhip Bekteshi, të cilët bënë propagandë kundër regjimit dhe të zëvendësoheshin me oficerë më të zotë.³⁷ Për të bërë të mundur hyrjen menjëherë në veprim të trupave ushtarake në raste të jashtëzakonshme, ai i propozoi KPFA-së që këto trupa të vihehin në dispozicion të prefekturës dhe komandës së xhandarmërisë, pa pritur

³⁶ *Po aty*, F.152, V.1925, D.21, fl.1. Telegram i KPFA-së, MPB, Tiranë, 11.4.1925; *Po aty*, fl. 4. Telegram i prefekturës së Beratit, MPB, Berat, 21.5.1925; *Po aty*, F.152, V. 1926, D.187. Telegram i MPB, Zonëkomandës së Lindjes Peshkopi, Tiranë, 05.03.1926.

³⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D.6, fl.1. Informacion i MPB, KPFA-së, Tiranë, 16.05.1925.

korrespondencë tjetër apo pa kërkuar autorizim veprimi.³⁸ KPFA-ja e gjykoi si të ngutshme krijimin e një detashmenti lëvizës për ta dërguar si përforcim në qarkun e Shkodrës dhe kërkoi shtim të rezervave të municioneve në atë zonë.³⁹

Gjithashtu, Cena beu propozoi që ushtarakët e qarkut të Shkodrës, të zëvendësoheshin me ushtarakë nga Shqipëria e Mesme dhe e Jugut. Marrja e një mase të tillë do të shmangte rastet kur ushtarët vendas mund të mos vepronin kundër pjesëmarrësve në lëvizje antiqeveritare, të cilët mund të ishin në mes tyre fis ose bashkëfshatarë. Një gjë e tillë sipas zakonit të vendit shkaktonte të drejtën e gjakmarrjes. Në këto raste ushtarët ose nuk do të vepronin ose do të kalonin në anën e kundërshtarëve. Në të njëjtën kohë, ai shihte të nevojshme zhvillimin e propagandës proregjimit dhe të sqaroheshin ushtarët për synimet e veprimet e të arratisurve.⁴⁰ Në përgjigje të këtij shqetësimi, KPFA, urdhëroi qarkullimin e ushtarëve vendas me ushtarë nga krahina të Shqipërisë së Jugut dhe asaj të Mesme. U porositën drejtoritë e rekrutimit që rekrutimi në të ardhmen, të zhvillohej sipas këtij urdhri.⁴¹ Një masë e tillë, u vlerësua nga MPB, jo vetëm për të shmangur gjakmarrjen por do të ndihmonte pozitivisht në forcimin e kombit, lidhjet ndërkrahinore, në shkëmbimin e kulturave e zakoneve të zonave të ndryshme të vendit.

Situata në zonën e Malësisë së Shkodrës po përkeqësohej përditë e më shumë. Qeveria ishte vënë në dijeni se autoritetet e Beogradit, për të penguar lidhjen e A.Zogut me Italinë, në bashkëpunim me të arratisurit politikë të strehuar në Jugosllavi ishin hedhur në veprim për ta shfrytëzuar atë kundër regjimit. Rreziku për shpërthimin e lëvizjes antizogiste në krahinën e Dukagjinit ishte bërë i dukshëm. Në ato kushte realisht të vështira për qeverisjen dhe vendin, A. Zogu dhe KPFA-ja u detyruan të ndërprisnin programin për organizimin e ushtrisë mbi bazën e sistemit të milicisë të sapo vënë në zbatim. Kështu u anulua stërvitja e kontingjentit të dytë të rekrutëve në qendrat e instruksionit, që do të

³⁸ *Po aty*, fl.6. Propozim i MPB, Ceno beut, KPFA-së, Mbi veprimin e kompanive ushtarake në Shkodër.

³⁹ *Po aty*, fl.6. Mbi krijimin e një detashmenti shëtitës.Telegram i MPB, KPFA-së, Tiranë, 17.05.1925.

⁴⁰ *Po aty*, fl.2. Propozime të MPB mbi rekrutimin e ushtarëve në Shkodër, KPFA-së, Tiranë, 17.05.1925.

⁴¹ *Po aty*, fl.25. Telegram i KPFA-së, MPB, Tiranë, 20.5.1925, Mbi shpërndarjen e rekrutëve të rinj.

fillonte më 1 shtator 1925. Me rekrutët ekzistues u organizuan pesë kompani këmbësorie, një kompani mitralierë dhe një bateri artilerie. Këto forca u angazhuan për të kryer çarmatimin e popullsisë sepse armët në duart e popullsisë në mënyrë të çorganizuar përbëjnë kurdoherë kërcënim për ruajtjen e rendit e qetësisë në vend.⁴²

Ky operacion filloi në fund të gushtit dhe përfundoi në nëntor 1925. Lajme shqetësuese vinin nga Shqipëria e Jugut për organizimin e një lëvizjeje të mundshme nga emigrantët politikë në Korfuz e Janinë. Në përgjigje të situatës, KPFA-ja dërgoi në Këlcyrë një kompani instruksioni si forcë operacionale e qeverisë.⁴³ Nisur nga situata brenda vendit, A. Zogu dhe KPFA vendosën që për një periudhë katërvjeçare të bënin një organizim të qëndrueshëm të ushtrisë. Ky organizim si drejtim kryesor kishte stërvitjen e rekrutëve. Kështu nëntë zonat e rekrutimit do të mobilizonin rekrutët në nëntë kompani instruksioni këmbësorie dhe tre kompani instruksioni mitraljerë të cilat do të kryenin stërvitjen në qendra instruksioni për gjashtë muaj dhe më pas do të shpërndareshin sipas armëve në formacione ushtarake lëvizëse, kryesisht në ruajtje të kufirit për gjashtë muaj të tjerë. Edhe gjatë këtij gjashtëmujori, rekrutët krahas gadishmërisë për t'iu përgjigjur çdo situatë, do t'i nënshtroheshin stërvitjes së rregullt ushtarake.⁴⁴ Ndërsa rekrutët e armës së artilerisë, pas periudhës së stërvitjes qëndronin në qendrën e instruksionit të inkuadruar në toga artilerie të gatshëm për të marrë pjesë në operacionet e mundshme luftarake. Mbas një viti shërbimi ushtarak, ata transferoheshin në zonat e tyre si rezervistë. Në këtë rast qeveria do të kishte në dispozicion si forca të qëndrueshme, tre batalione lëvizëse, nëntë kompani këmbësorie, tre kompani mitralierë, gjashtë kompani kufiri, tre toga artilerie me gjashtë gryka zjarri.⁴⁵

⁴² *Po aty*, F.163, V. 1925, D. 2, fl.1. Telegram i konsullit Italian në Sarandë, Legatës italiane në Durrës, Sarandë 28.5.1925.

⁴³ *Po aty*, F.178, V. 1925, D. I-745, fl.10. Vendime të Kryesisë së Republikës, Shtatmadhorisë, mbi organizimin e ushtrisë dhe xhandarmërisë. Kryesia e Republikës, Ministrisë së Financave, Tiranë, 21.12.1925.

⁴⁴ *Po aty*, fl.11.

⁴⁵ *Po aty*, fl.14. Struktura do të përbëhej: KPFA-ja, në përbërje të së cilës ishte intendenca e KPFA-së, inspektoria e përgjithshme e ushtrisë, komanda e grupit (me detyrë administrimin dhe drejtimin e stërvitjes) që përfshinte tre zona rekrutimi dhe tre depo rekrutësh këmbësorie, një depo rekrutësh mitraliere, një bateri artilerie (gjysma në lëvizje dhe gjysma në stërvitje) dhe një spital. Në vartësi të

Nevoja për kuadro me përvojë e detyroi A.Zogun të kthente sytë te ushtarakët e liruar në fillim të vitit 1925 se dhe te ushtarakët e arratisur të cilët ishin kthyer në atdhe, duke tërhequr më të aftët në shërbimin ushtarak. Gjithashtu në mënyrë të përsëritur kërkonte prej KPFA-së emërimin e oficerëve të rinj. “Ndaj tyre, - theksonte ai, - duhej të mbahej qëndrim më tolerant përfshirë edhe ndaj ndonjë rasti të komprometimit të tyre politik, pasi ata do të ishin nën kujdesin e komandën e oficerëve eprorë”.⁴⁶

Struktura e re e ushtrisë dhe marrja në angazhim prej saj e detyrës së ruajtjes së kufirit solli ndryshime dhe në organizimin e xhandarmërisë. Në fund të vitit 1925 filloi shkrija e dhjetë kompanive shëtitëse që ishin në vartësi të saj dhe detyrat e tyre do të kryheshin nga nënrepartet e rregullta të ushtrisë. Kjo do të çonte në rritjen e kompetencave të ushtrisë, do të forconte disiplinën në radhët e forcave të armatosura, bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë midis ushtarakëve dhe do të ngrinte autoritetin e oficerëve deri atëherë jo aq i respektueshëm nga xhandarët e policët.⁴⁷ Mbi këtë bazë qeveria parashikoi që buxheti i ushtrisë për vitin 1926 të ishte 3,7 milion fr.ari, i xhandarmerisë 3,3 milion fr.ari. Gjithsej 7 milion fr.ar, pa përfshirë shpenzimet për marinën dhe kredinë e jashtëzakonshme për blerjen e armatimit.⁴⁸ Për të mbuluar deficitin buxhetor që do t'i shkaktohej arkës së shtetit, A. Zogu iu drejtua Italisë për një hua prej dy milion fr ar dhe pesë milion fishekë.⁴⁹ Ai mundi t'i siguronte tre milion lira dhe pjesën më të madhe të armatimit, pas nënshkrimit të paktit sekret të gushtit të vitit 1925.⁵⁰ Huaja i dha

KPFA-së ishin nëntë drejtoritë e rekrutimit, gjyqi ushtarak, shkolla ushtarake, puntoria ushtarake, kryemagazina dhe banda e ushtrisë. E pa ndryshuar do të mbetej ngritja e formacioneve ushtarake në rast mobilizimi të përgjithshëm.

⁴⁶ *Po aty*, fl.13.

⁴⁷ *Po aty*, F.152, V. 1926, D.462, fl.12. Informacion i Komitetit të Zonës së Jugut, MPB, Sarandë 05.05.1926.

⁴⁸ *Po aty*, fl.15.

⁴⁹ Pietro Pastoreli, *Italia e Albania 1924-1927*, Firenze: 1967, f.160.

⁵⁰ Giovanni Zamboni, *Mussolinis expansions politik auf dem Balkan*, Helmut Buske Verlag Hamburg: 1970, f. XXVIII, f.9; P. Pastoreli, *Italia ...*, f.160. Pas nënshkrimit të konventës për Bankën Kombëtare Tregtare dhe huanë SVEA, qeveria italiane shfrytëzoi situatën e vështirë financiare të Shqipërisë dhe kërkesën për hua të qeverisë shqiptare, për ta nënshtruar politikisht. Në maj-qershor 1925, Roma i vuri si kusht qeverisë shqiptare, nënshkrimin e tre marrëveshjeve me anë të

frymëmarrje qeverisë shqiptare për likuidimin e pagave në administratë dhe xhandarmëri, por ishte e pamjaftueshme për vazhdimin e ristrukturimit të ushtrisë e për të mbajtur në këmbë administratën shtetërore.

Megjithëse të gjendur në vështirësi, A.Zogu si Komandant i Përgjithshëm dhe KPFA, vazhduan punën si në organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ushtrisë. Kështu në fund të vitit 1925, KPFA i paraqiti Kryetarit të Republikës projektligjin mbi kompletimin dhe gradimin e oficerëve.⁵¹ Pas diskutimeve në parlament, projektligji u plotësua dhe hyri në fuqi në nëntor 1927. Në këtë ligj përcaktohej që kompletimi i ushtrisë të bëhej vetëm me oficerë të përgatitur në shkolla ushtarake në degët këmbësori, artileri dhe mitraljerë. Djemtë të cilët pretendonin të ndiqnin shkollën ushtarake duhej të kishin kryer të paktën gjashhtë klasë të shkollës shqiptare. Për nevojat e ngutshme të ushtrisë për oficerë, u pranua gradimi aspirantë i atyre nënoficerëve që kishin shërbyer katër vjet në ushtri, duke i nënshtruar një provimi para një trupe ushtarake. Gjithashtu në ligj përcaktoheshin rregullat e gradimit të oficerëve. Oficeri mund të kalonte nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë pasi të lirohej vendi i punës, të kishte treguar aftësi për gradën që mbante dhe të jepte provim në teori e praktikë për të dëshmuar se e

të cilave kërkonte njohjen e të drejtës për të ndërhyrë në Shqipëri pa miratimin e Lidhjes së Kombeve, t'i njiheshin koncesione në fushën ekonomike si lidhjen e një pakti të fshehtë ushtarak italo-shqiptar. A.Zogu refuzoi marrëveshjen politike, e cila cenonte sovranitetin e Shqipërisë. Ai pranoi të nënshkruante marrëveshjen ushtarake, e cila pas një korrespondence midis Musolinit dhe Zogut u firmos në 26 gusht. Në këtë marrëveshje parashikohej mbrojtja e të dy vendeve në rast kërcënimi nga jashtë me anë të forcave të përbashkëta ushtarake, të udhëhequra nga një shtab i përbashkët. Me insistimin e A.Zogut, u arrit që në marrëveshje të përfshihej kërkesa e propozuar prej tij që në rast se do të shtrohej çështja e rishikimit të kufijve, Italia do të angazhohej në realizimin e bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Gjithashtu një klauzolë i kushtohej mbajtjes sekret të marrëveshjes. Publikimi i saj do të bëhej vetëm me marrëveshje të të dy palëve, sepse kjo do ta vinte Italinë në konflikt me Jugosllavinë.

Lidhur me shumat financiare të dhëna nga Italia, për qeverinë shqiptare sillen të dhëna të ndryshme. Për shkak të mungesës së dokumenteve shqiptare më të besueshme në këtë rast janë të dhënat e sjella nga studiuesi P.Pastoreli.

⁵¹ *AQSH*, F.149, V. 1926, D. II-185, fl.1. Projektligj mbi kompletimin dhe gradimin e oficerëve aspirantë. KPFA, Kryesisë së Republikës Tiranë, 11.12.1925.

meritonte gradën që kërkonte.⁵² Në ligj përcaktohej koha minimale e qëndrimit në një gradë.⁵³ Po kaq i rëndësishëm ishte dhe ligji mbi gradimin e graduatëve. Ata ndaheshin në dy grupe:a) nënoficerë aktivë (të shërbimit aktiv), b) nënoficerë me pagë.⁵⁴ Si rezultat i këtyre masave në vitin 1926, pati një rritje të numrit të oficerëve në strukturat e ndryshme të ushtrisë.⁵⁵

Gjatë vitit 1926, ristrukturimi i ushtrisë por edhe reformat në administratën e vendit po ecnin me hapa shumë të ngadalshëm, për shkak të krizës financiare që po kalonte vendi. Këtë situatë e shfrytëzoi përsëri qeveria italiane duke i kërkuar A. Zogut pranimin dhe nënshkrimin e një pakti politik, i cili ndonëse i referohej vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921, në kundërshtim me të synonte t'i siguronte të drejtën e plotë që të vepronte pa ndërmjetësimin e Lidhjes së Kombeve për të mbrojtur Shqipërinë në rast se kjo sulmohej nga ndonjë fuqi e huaj.⁵⁶ A. Zogu e kundërshtoi projektin e Romës. Në bisedimet disamujore përballë presionit të fuqishëm italian me kundërprojekte, synonte të vinte marrëveshjen mbi baza reciprociteti dhe të ulte sa të ishte e mundur rreziqet që mund t'i vinin prej saj pavarësisë së Shqipërisë. Në

⁵² *Ligje, Dekret ligje rregullore, viti 1927*, Tiranë: 1939, f.399-403.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ *Po aty*, f.155. Nënoficerët me pagë ishin: tetari 60 fr ar, rreshteri 70 fr ar, kapteri 90 fr ar.

⁵⁵ T.Selenica, *Shqipëria ...*, f.XXVIII; *AQSH*, F. 149, V. 1925, D.II-180, fl.1. KPFA, Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Tiranë, 26.2.1925; *Po aty*, fl.3. Kryetari i Republikës, KPFA, 15.04.1925; *Po aty*, fl.4. Telegram i KPFA, Kryetarit të Republikës, Tiranë, 06.07.1925. Në vitin 1926 kompletimi i strukturave të ushtrisë me oficerë ishte: KPFA-ja-29 oficerë, inspektoria e përgjithshme-2, gjykata ushtarake-2, shkolla e aspirantëve në qendër-6, shkolla e mitralierve në Durrës-3, shkolla e baterisë në qendër-4, depo e përgjithshme në qendër-X, banda e ushtrisë-5, puntoria ushtarake 2, 9 drejtoritë e rekrutimit-46, batalioni sulmues 16, 6 bateritë me 4 gryka zjarri-3, detashmenti rus-9, komanda e qendrës-1, kompanitë e instruksionit të këmborisë-48, ato mitraliere-12.

Detashmenti rus mbështeti A.Zogun për t'u rikthyer në pushtet. Në shkurt të vitit 1925, KPFA i kërkoi Këshillit të Ministrave, shpërndarjen e detashmentit rus meqenëse ishte krijuar kompania mitraliere dhe bateritë shqiptare. Por Kryetari i Republikës sugjeroi që detashmenti të mbahej në shërbim derisa të aftësoheshin trupat shqiptare. Kështu detashmenti rus i cili pëfundonte kontratën me 1 gusht iu shty kontrata edhe për tre muaj të tjerë.

⁵⁶ Pietro Quaroni, *Valixhja Diplomatike*, Tiranë: "Albinform", 1993, f.109.

këtë situatë, autoriteteve të vendit u tërhoqi vëmendjen dhe u krijoi shqetësime të mëdha Lëvizja e Dukagjinit, e cila filloi në nëntor të këtij viti. Kjo e detyroi A. Zogun t'i jepte fund përpjekjeve për përmirësime të mëtejshme të marrëveshjes e të kthente vëmendjen brenda vendit. Nevoja për të holla për mobilizimin e forcave të rregullta të ushtrisë dhe të forcave të xhandarmërisë për të shtypur kryengritjen, e cila kishte përparuar në drejtim të Shkodrës, e detyruan atë të nënshkruante në 27 nëntor 1926, Paktin e Miqësisë e të Sigurimit.⁵⁷ Me anë të Paktit, Italia ia arriti të zëvendësonte garancinë e katër fuqive që i ishte njohur Shqipërisë në vitin 1921 prej Konferencës së Ambasadorëve me angazhimin e saj aktiv, të bazuar në interesa direkte në Shqipëri. Gjithashtu Pakti forcoi pozitën e A. Zogut dhe krijoi mundësinë për zhbllokimin e marrëdhënieve ekonomike financiare dypalëshe me efekte jetike për ekonominë shqiptare e konsolidimin e shtetit shqiptar.⁵⁸

Ndikimi italian në forcat e armatosura shqiptare

Nënshkrimi i marrëveshjeve ekonomike dhe politike, u pasuan me marrëveshje të tjera në fushën e mbrojtjes të cilat ndikuan në strukturimin dhe organizimin e ushtrisë shqiptare. Ato i shtruan rrugën Musolinit për të konsoliduar fortesën shqiptare edhe në fushën e mbrojtjes. Nga pikëpamja strategjike, Shqipëria u konsiderua nga italianët më e përshtatshme se Sllovenia për t'i marrë krahët ushtrisë jugosllave.⁵⁹ Synimi i italianëve ishte të krijonin një ushtri shqiptare të përshtatshme për këtë aksion. Për këtë së bashku me marrëveshjen, palës shqiptare iu kërkua që të pranonte oficerë italianë në të gjitha degët e ushtrisë shqiptare. Po atë ditë të nënshkrimit të traktatit, Këshilli i Ministrave i çeli dritën jeshile kontingjentit të parë të oficerëve prej dyzet vetësh me gradën nëntoger e deri nënkolonel dhe vendosi t'i shpërndajë si organizatorë pranë strukturave drejtuese të ushtrisë dhe në komandat e formacioneve gjitharmëshe.⁶⁰ Droja se kërkesat e qeverisë italiane do të shtriheshin në këto përmasa dhe në degë të tjera të administratës, po atë

⁵⁷ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), D.95, V.1926, fl. 65-167. Pakti i miqësisë dhe i sigurimit, nëntor 1926.

⁵⁸ Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane, 1920-1934*, Tiranë: ShB, 2002, f.118.

⁵⁹ P.Quaroni, *Valixhja ...*, f.199.

⁶⁰ AQSH, F.152, V.1927, D.753, fl. 35-37. Vendim i Këshillit të Ministrave, 22.11.1927.

ditë, Këshilli i Ministrave vendosi që prej kësaj dite në asnjë degë të administratës shtetërore nuk duhej të merreshin organizatorë të huaj pa pëlqimin e këtij këshilli.⁶¹

Mbështetur në ndihmat financiare të qeverisë italiane, qeveria shqiptare dhe KPFA, deri në fund të vitit 1927 e plotësuan ushtrinë shqiptare me formacione të reja, si banda presidenciale me 54 civilë, shkolla e artilerisë në Tiranë, 3 spitale në Tiranë, Shkodër e Elbasan, shërbimi veteriner në Tiranë, batalioni i gardës presidenciale batalionet “Erzeni”, ”Vjosa”, “Skënderbeu”, “Semani”, “Devolli”, 5 batalione kufitare, grupi i artilerisë në Tiranë, kompania e xhenios, komanda e transportit, detashmenti i punëtorive⁶². Nga 136 oficerë me grada që kishte ushtria në vitin 1926, numri i tyre arriti në 347 në vitin 1927.⁶³ Oficerët italianë paguheshin nga shteti shqiptar. Pagat e tyre ishin më të larta se ato të oficerëve shqiptarë.⁶⁴

Për të zgjeruar praninë italiane në fushën e mbrojtjes pas një viti, Musolini i ofroi A. Zogut paktin tjetër të quajtur Pakti i Dytë i Tiranës, i cili u nënshkrua më 22 nëntor 1927. Ky u quajt Traktati i Aleancës dhe i Mbrojtjes.⁶⁵ Në nenin 3 të Paktit theksohej se “Në rastin kur njëra prej palëve kërcënohet nga një luftë që nuk e ka provokuar ajo, pala tjetër angazhohet të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion të saj, jo vetëm për të penguar fillimin e luftimeve por edhe për të siguruar përmbushjen e angazhimeve ndaj palës së kërcënuar”. Ndërsa neni 4 plotësonte se, “Në rast se të gjitha përpjekjet për rregullimin paqësor të çështjes dështojnë, secila prej palëve të lart kontraktuese angazhohet të bëjë gjithshka është e mundur dhe të verë në dispozicion të tjetrës të gjitha burimet ushtarake dhe financiare e të tjera, në rast se një ndihmë e tillë kërkohet prej palës

⁶¹ *Po aty*.

⁶² T.Selenica, *Shqipëria ...*, f. LXXVIII.

⁶³ *AQSH*, F.152, V.1926, D.181, fl.7. Informacion i zyrës sekrete, mbi gjendjen e oficerëve me grada në ushtri. Sipas këtij informacioni, në 136 oficerë dy ishin kolonelë, katër nën/kolonelë, 13 major, të tjerët ishin kapitenë, togerë, nën/togerë e aspirant.

⁶⁴ *Po aty*, F.149, V.1928, D.II-244, fl.16. Vendimi i Kësh. të Minis., nr.165, prill 1928; *Po aty*, f.14. Vendim i KM nr. 178, 6.4.1928. Një major italian paguhej me pagën e nënkolonelit, ose kapiteni italian pranë intendancës paguhej me dyfishin e pagës së oficerit shqiptar me të njëjtën gradë.

⁶⁵ *Po aty*, F.146, V.1927, D.95, fl.286. Procesverbal mbi Paktin e Dytë të Tiranës, 26.11.1927.

tjetër të kërcënuar.”⁶⁶ Ndonëse italianët i kishin dhënë Paktit një formë që dukej si pakt bilateral ai u shërbeu si një bazë për nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh të karakterit ushtarak në të ardhmen, që çuan në rritjen e veprimtarisë ushtarake italiane në Shqipëri.⁶⁷

Pas nënshkrimit të Paktit dhe rritjes së bashkëpunimit me forcat ushtarake italiane, KPFA-ja pas konsultimeve me A. Zogun rishikoi planin e reformimit të ushtrisë. I paraqiti Këshillit të Ministrave propozimin për hartimin e një projektligji ku të pasqyroheshin ndryshime në formacionet ekzistuese dhe në formimin e reparteve të reja.⁶⁸ Projektligji me strukturën dhe organikën e ushtrisë, iu paraqit për diskutim Dhomës së Deputetëve në mars 1928. Në qershor 1928, u miratua dhe hyri fuqi.⁶⁹ Organika e ushtrisë plotësohej me disa elementë e shërbime ndihmëse. Mbështetur në artikullin 75 të statutit themeltar, ligji sanksiononte se të gjitha komandat e fuqive të armatosura ishin në dorë të Kryetarit të Republikës. Në ligj përcaktohej struktura e ushtrisë si më poshtë: 9 batalione këmbësorie, 1 kompani mitraljerë, 1 batalion i gardës, 5 batalione kufitare këmbësorie, 1 kompani e qendrës në garnizonin e Tiranës, banda e ushtrisë dhe banda presidenciale, trupa vullnetare (përfshi dhe detashmentin rus), repartet e artillerisë që përbëheshin nga 6 bateri malore me nga dy gryka zjarri të kalibrit 65 m/m, 1 bateri artillerie malore e gardës me 4 gryka zjarri të kalibrit 75 m/m, 1 bateri në shkollën e artillerisë, trupat teknike me 4 kompani xheniere, shërbimi shëndetësor, veteriner, i ushqimit, ai gjyqësor që kryhej nga gjykata ushtarake. Të drejtën e urdhrit për në gjyq e kishte KPFA-ja.⁷⁰ Mbeteshin të pandryshuara 9 drejtoritë e rekrutimit. Rekrutimi, ashtu si në vitin 1926 mbetej rajonal për trupat e këmbësorisë dhe kombëtar për armën e artillerisë dhe mitralimet, pasi këto dy të fundit kërkonin një kontingjent më të aftë, që nuk mund të sigurohej veçse në shkallë kombëtare. Gjithashtu ligji përcaktonte shkollat ku do të

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ Bernd Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: “Çabej”, 1996, f.137.

⁶⁸ *AQSH*, F.149, V. 1928, D.II-241. Relacion i KPFA, Kryesisë të KM, 16.02.1928.

⁶⁹ *Po aty*, F.146, V. 1928, D.10, fl.1. Kryesia e Këshillit të Ministrave, Dhomës së Deputetëve, Projektligj organik për ushtrinë e xhandarmërinë.

⁷⁰ *Fletorja Zyrtare*, nr. 69, 30.06.1928, f.5. Projekt ligji i ushtrisë e i xhandarmërisë.

përgatiteshin oficerët e armëve e shërbimeve të ushtrisë. Në Tiranë ishte shkolla e aspirantëve dhe gjimnazi ushtarak, në Durrës, shkolla e mitraljerëve dhe ajo e marinës. Për pajisjen e ushtrisë me armatime, municione e teknikë luftarake, qeveria bleu nga Italia pushkë, artileri malore, e municione.⁷¹Gjithashtu në vitin 1927 u mor vendimi për shkrirjen e kompanive të mbetura shëtitëse. Zëvendësimin i tyre me trupa të rregullta, rriti shpenzimet ushtarake.

Si rezultat i masave të marra nga qeveria shqiptare dhe interesimit të palës italiane, ushtria shqiptare gjatë vitit 1927 u rrit jo vetëm në strukturë dhe në numër por dhe në pajisje me armatim e teknikë luftarake. Sipas raportit të shefit të Shtatmadhorisë, Myrdac, në fund të këtij viti, ushtria numëronte 11.000 ushtarë e oficerë, nga 6000 që ishte parashikuar, përfshi edhe kontingjentin e ushtarakëve italiane.⁷²Për mbajtjen e kësaj force, u shpenzuan 48% e buxhetit të shtetit për vitin 1927-1928, pa përfshirë fondet e veçanta për blerjen e armëve.⁷³ Siç shihet shpenzimet në fushën ushtarake zinin afërsisht ½ e buxhetit të shtetit, që megjithëse si vlerë nuk përbënin ndonjë shumë të madhe, ishin një barrë e rëndë për financat e dobëta të shtetit shqiptar. Për studiuesin Swire, buxheti i lartë mund të përlligjej për faktin se në ushtri rekrutët veç disiplinës e stërvitjes ushtarake mësonin shkrim e këndim, aftësoheshin për të kuptuar e trajtuar problemet më gjerë se sa kultura, psikologjia e mentaliteti i zonës prej nga vinin etj.⁷⁴ Veç kësaj, rritja e numrit të ushtrisë dhe zgjatja e shërbimit ushtarak në tetëmbëdhjetë muaj që kërkonte buxhetin e mësipërm, u imponua nga situata e brendshme dhe e jashtme që kaloi vendi gjatë regjimit republikan si dhe rritja e ndikimit italian. Italia është e interesuar për të pasur në Shqipëri një ushtri të konsoliduar, për ta ndihmuar në një aksion të mundshëm kundër Jugosllavisë. Përpyekjet e saj në këtë drejtim, thekson P.Quaroni, shkonin

⁷¹ Owen Pearson, *Albania and King Zog. Independence Republice and Monarchy, 1908-1939*, Londër: 2004, f.277.

⁷² *Po aty*, f. 281.

⁷³ A.Bulica, *Logjistika ...*, f.116; Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: "Dituria", 2005, f. 396. Qeveria shqiptare në vitin 1927 bleu nga Italia, 20.000 pushkë, 40 topa malore, 120 mitrolozë e furnizime të tjera ushtarake që i kapërcente kërkesat e ushtrisë shqiptare.

⁷⁴ J. Swire, *Shqipëria ...*, f. 396.

paralel me përforcimin e ushtrisë jugosllave nga Franca në kuadër të paktit franko-jugosllav⁷⁵.

Në realizim të politikës midis dy shteteve në fushën e mbrojtjes, në gusht të vitit 1928 u realizuan një sërë marrëveshjesh ushtarake të cilat përcaktuan mënyrën e zbatimit të Paktit, duke fuqizuar influencën e kontrollin italian në ushtrinë shqiptare.⁷⁶ Sipas marrëveshjeve qeveria shqiptare detyrohej të merrte në ushtri vetëm oficerë italianë të cilët do të mbanin uniformë shqiptare por u ndalohej të merrnin nënshtetësi shqiptare. Kontingjenti i tyre do të arrinte deri në 280 vetë.⁷⁷ Në krye të këtij misioni ushtarak u emërua gjenerali italian Alberto Pariani. Veç organizatorëve pranë strukturave të mbrojtjes të cilat nuk duhej t'i kalonin 6000 vetë, u ngrit një shtab ushtarak që do të komandohej nga Kryetari i Republikës e jo nga Komanda e Lartë e ushtrisë. Por kjo e drejtë e tij kufizohej nga fakti se pranë tij ishte caktuar një këshilltar ushtarak italian i plotfuqishëm në çështjet ushtarake, pa këshillat e të cilit Kryetari i Republikës nuk mund të merrte as një vendim. Sipas marrëveshjes, në rast lufte, do të krijohesh një komandë e Lartë e përbashkët që duhej t'i nënshtrohej komandantit suprem të Forcave të Armatosura italiane. Gjithashtu marrëveshja i jepte të drejtë ushtrisë italiane të pushtonte bregun shqiptar për qëllimet e luftës në mbrojtje të vendit.⁷⁸ Traktati i Mbrojtjes e Sigurisë dhe marrëveshja për zbatimin e tij, i garantuan Italisë pozitë dominuese në Adriatik. “Me anë të këtij traktati, - theksonte gazeta “Foglio d’ordini” organ i Partisë Fashiste, - problemi i Adriatikut, si problem themelor për sigurinë e Italisë, u zgjidh një herë e mirë me garantimin e pavarësisë e tërësisë tokësore të Shqipërisë”.⁷⁹ Propaganda fashiste evidentonte gjerësisht rëndësinë e traktatit si shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e sigurinë e Shqipërisë.

Ndonëse në vështirësi të gjithanshme që po kalonte vendi dhe shoqëria shqiptare si në aspektin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar,

⁷⁵ P. Quaroni, *Valixhja ...*, f. 199.

⁷⁶ *I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: DDI), Settima Serie (1922-1935), Vol. VI, Romë 1967, f. 538-543. Accordi militari per l'applicazione del trattato d'alleanza tra l'Italia e l'Albania.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*, f.543. Alberto Pariani u dërgua për herë të parë në Shqipëri me gradën kolonel si atashe ushtarak në Legatën italiane në Durrës. Në gusht 1928 u emërua gjeneral dhe shef misioni ushtarak italian në Shqipëri.

⁷⁹ *Dielli*, nr. 4038(731), 17.01.1928, f.1.

A. Zogu dhe qeveria e tij në vitet 1925-1928 nisën riorganizimin e ushtrisë, hodhën hapa në hartimin dhe miratimin e një sërë ligjesh e në zbatim të tyre nxorën rregulloret përkatëse, urdhra e udhëzime, të cilat bënë të mundur strukturimin dhe funksionimin e ushtrisë shqiptare. Vunë në baza organizative, dhe disiplinuan proceset e rëndësishme të rekrutimit, stërvitjes, përcaktimit e aftësisë trupore e profesionale të ushtarakëve, shkollimin e oficerëve, përmirësuan figurën morale të ushtarakut, forcuan rregullin e disiplinën në ushtri mbi bazën e zbatimit të ligjeve të shtetit dhe rregulloreve ushtarake. Te gjitha këto i dhanë ushtrisë shqiptare fizionominë e një ushtrie të rregullt.

S u m m a r y

THE REORGANIZATION OF THE ARMED FORCES IN ALBANIA (1925-1928)

After his return in December 1924, A. Zogu made a number of legislative changes that aimed at justifying his coming in power and at the same time paid special attention to the reformation of the military forces. This paper focuses on the political reasons that made A.Zogu disperse the army, make the War Ministry non-functional and take legislative measures to separate the military from the politics and establish new leading structures in the army.

Due to a bad financial situation he decided to decrease the number of military who at that time numbered around 7000 people. To this end was ordered the dispersal of the army and gendarmerie units. There were kept only three training companies with 100 people each located in Permet, Delvine and Korce and their headquarters in Tirane, Shkoder and Berat.

Based on archival and bibliographical data, this paper analyses the reforms that took place in the army and turned it in a militia. The bulk of this system was the establishment of a High command which would lead a permanent body of officers and other officials who would work as instructors for different arms. They would train the new recruits who after finishing the military service would become reservists in their home towns.

Furthermore, in the paper will be presented the way the reform went on, pointing out the interior and foreign reasons that forced the government to interrupt the organization of the army as a militia and to switch to a standing army which would handle the deteriorated situation in the country.

A special focus is given to the legal framework which made recruitment a well organized and disciplined process, through military training, evaluation of the physical and professional abilities of the military by strengthening order and discipline in the army. The closer relations with Italy during 1925-28, increased the pressure that Mussolini exercised to achieve a greater Italian influence in the Albanian army. His aim was fulfilled with the signing of the Treaty of Friendship and Defense of November 1927 and other later agreements of a military character. In this paper will be examined and highlighted the effects of these agreements in the structuring of the army and the increased Italian military activity in Albania during these years.